



Prishtinë: 23 korrik 2009
Kodi i ZRRE: V_203_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Nenin 29.3 të Rregullës mbi Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me Energji,
3. Nenin 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
4. Kërkesën e Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A (tani e tutje KEK) për miratimin Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar të Energjisë Elektrike;

në seancën e mbajtur më 23 korrik 2009, ka nxjerrë këtë:

VENDIM


Miratohet Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

1. Me datë 16.07.2009 KEK-u ka parashtruar kërkesë për miratimin e Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.
2. Pas shqyrtimit të kërkesës së KEK-ut dhe plotësimit të procedurës me komente shtesë, Bordi i ZRRE-së ka vendosur të miratojë Procedurën.
3. Pas marrjes së vendimit nga ZRRE-ja apo publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, KEK do të publikojë këtë procedurë në faqen e vet elektronike.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Palët e pakënaqura kundër këtij vendim mund të paraqesin ankesë në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga ana e Bordit të ZRRE-së.


Bashkangjitur:

Procedura për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike

Bordi i ZRRE-së




Ali Hamiti, kryesues




Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar



Përparim Kabashi, anëtar



Blëfim Koci, anëtar